Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br./Br. 60/17, 67/17
Datë/Datum 27.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Ministria e Shëndetësisë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit Visar Emini - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **60/17** dhe **67/17.**		
Datë:	27.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 28.02.2017 me Nr. **60/17** nga OE **"ICN&BN"** – Prishtinë dhe ankesën e parashtruar me dt: 07.03.2017 me Nr. **67/17** nga OE **"TRIO MED"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, me numër të prokurimit: 206/16/103/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **ICN&BN & TRIO MED.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		16.03.2017		**16.03.2017**		**27.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 28.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **60/17** e parashtruar nga OE **"ICN&BN"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, me numër të prokurimit: 206/16/103/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

Me datën 07.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **67/17** e parashtruar nga OE **"TRIO MED"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, me numër të prokurimit: 206/16/103/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë së Shëndetësisë (MSH).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues:

Pikat e Ankesës nga OE **"ICN&BN"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 52 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Sipas procesverbalit te hapjes shihet qartë se ne kemi qene firma qe ka ofertuar me çmim me te ulet dhe se nuk ka pas nenkritere tjera ne te cilat është AK-ja me rastin e eliminimit te ofertës tone.

Pikat e Ankesës nga OE **"TRIO MED"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 56 - Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës;
Neni 69 - Aftësia teknike dhe / ose profesionale;
Neni 72 - Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Per lotet 22, 23 dhe 24 te këtij aktiviteti te prokurimit ne si OE kemi ofertuar me cmimet me te lira ne raport me te gjith ofertuesit e tjer, ndersa AK-ja, per keto llote ka shpallur fitues nje kompani tjeter e cila ka ofertuar nje cmim me te shtrejt per 6,440.10€.

AK-ja, na eliminon si te papërgjegjshëm per tre arsye:

1. Nuk e keni plotësuar kriterin: certifikata per prodhuesin ISO 13485:9001 - kopje.

Kjo arsye me te cilen AK-ja, pretendon se ne nuk e kemi plotësuar eshte e paqëndrueshme sepse ne kemi ofruar certifikaten me nr. Q2N 150581232005 e leshuar me date: 17.08.2015 dhe e cila eshte e vlefshme deri me date: 19.08.2018

Prova 1: email-i i derguar per verifikim nga AK-ja, tek kompania certifikuese TUV, certifikaten me nr Q2N 140781232003 & Q2N 150581232005 dhe pergjigja zyrtare nga TUV e përkthyer nga përkthyesi ligjor.

2. Nuk e keni plotësuar kriterin: Autorizim nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi (me te dhenat mbi prodhuesin, adresa, tel, email ueb faqja etj, per mundsi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi – dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi. Autorizimi "Trio Med", nuk i përmban te dhena e kërkuara ne njoftimin per kontrat dhe ne dosje te tenderit dhe si i till eshte dokument i pa pranueshem per komisionin e vlerësimit.

Kjo arsye se kinse autorizimi i ofruar nga ne nuk i permban te dhenat e kërkuara sic jane emri i kompanise ose adresa, eshte e pavertet sepse ne autorizim qe ne e kemi ofruar eshte shenuar cart emri dhe ardesa e prodhuesit, ndersa eshte i qendrueshem pretendimi se ne kete dokument nuk eshte shenuar ueb faqja e prodhuesit, mirëpo kjo nuk e bene kete dokument te pavlefshem. Ndersa per verifikimin e këtij dokumenti konsiderojm se ka qene shume e thjesht per komisionin vlerësues qe te beje nje verifikim te till sepse me vetem nje kërkim ne google nje gje e till do te vërtetohej. Nese asnjera nga keto nuk ka qene e mundur qe te behet nga komisioni dhe menqenese ky dokument ka qene ekzistent ne DT, ateher ky komision eshte dashur qe konform nenit 72 te LPP-se, te kërkoj sqarime nga ne si OE qe te sqarojm ose plotesojm kete dokument.

Prove: Autorizimi nga prodhuesi.

3. Nuk e keni plotësuar kriterin: Mostrat e produkteve, vetem nga nje cop dhe vetem nje dimension per nje lloj te produkteve. Ne oferten e dhene ka ofruar shiringa te prodhuesit Ahu Hongyu wuzhou medical – Kine, ndersa mostren e keni ofruar Beybi nga Turqia. Ne dokumentacionin e ofruar askund nuk figuron Beybi, andaj ka mospërputhje ne dokumentacion.

Ky pretendim i AK-se, nuk qendron sepse ne mostren qe ne kemi ofruar shihet qart se prodhuesi eshte kompania Hongyu wuzhou medical manifacturer – Kine, ndersa Beybi – nga Turqia eshte vetem importues i këtij produkti per shtetin Turk, prandaj, mendojm se ky pretendim eshte i pabazuar dhe tendencioz sepse te pretendosh se ka mospërputhje ne dokumentacion kjo eshte e pa pranueshme.

Prove 3: Mostra identike me ate te cilen e kemi dorezuar pran AK-se.

Kërkojmë nga OSHP, qe te merr për bazë te gjitha sqarimet e ofruara me lart dhe te beje verifikimin e saktë te dokumenteve dhe mostrave te prezantuara nga ne si OE dhe meqenëse ne kemi ofertuar me çmim me te lire për këto Lote atëherë OSHP, duhet te beje anulimin e dhënies se kontratës duke mbrojtur kështu interesin publik dhe aktivitetin e prokurimit te kthej ne rivlerësim.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 24.10.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 29.11.2016

Data e hapjes së ofertave .....29.11.2016-14:00^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 24 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
1. Te dëshmohet autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi. Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi-dileri kerkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.
2. Te dëshmohet regjistrimi i barit – autorizimi për marketing nga AKPM, me dozën e produktit te kërkuar.
3. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin: adresa, nr. tel, email, web faqja etj, per mundësi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi-dileri kerkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.
2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve te kërkuar.
3. Licenca valide nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet).

Regjistri i ofertuesit sipas procesverbalit të hapjes publike për LOT 9:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"ICN BN"	Prishtinë	144,936.00€ LOT 9	JO
2.	"Pharmex"	Prishtinë	152,256.00€ LOT 9	JO

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike për LOT 22, 23 dhe 24:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Trio Med"	Prishtinë	12,812.80€ LOT 22 68,951.60€ LOT 23 93,998.40€ LOT 24	JO

2.	"Made Kos"	Prishtinë	13,834.17€ LOT 22 73,202.29€ LOT 23 96,116.44€ LOT 24	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Berat Marmullaku - Kryetar i komisionit
- Besim Bajraktari - Anëtar i komisionit
- Bashkim Vatovci - Anëtar i komisionit
- Qendrim Daka - Anëtar i komisionit
- Labinot Zeqiri - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 06.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....08.02.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës (LOT 22, 23 dhe 24) në faqen e Krpp-së :.....15.02.2017

Data e njoftimit për Anulim te LOT 9 në faqen e Krpp-së :.....20.02.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit oferta ë PËRGJEGJSHME me çmim me te lire, për Lot 22, 23 dhe 24 është:

Nr.	Emri i tenderuesit të Suksesshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	Made Kos	13,834.17€ LOT 22€ 73,202.29€ LOT 23€ 96,116.44€ LOT 24€	1

Raporti i komisionit vlerësues për Lot 22, 23 dhe 24:

Ne baze te kriterit për dhënie te kontratës çmimi me i lire për dhënie te kontratës e rekomandojmë OE "Made Kos", për Lot 22 – 13,834.17€, Lot 23 – 73,202.29€ dhe Lot 24 – 96,116.44€.

Raporti i komisionit vlerësues për Lot 9.

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit për Lot 9 kanë ofertuar dy operator ekonomik, te cilët i kanë plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit, mirëpo kanë ofruar çmim disa here me te lart se çmimi i kontratës paraprake dhe me i lart se sa çmimi i tregut, andaj komisioni i vlerësimit rekomandon qe Lot 9 te anulohet.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE-te ankues konform nenit 108/A kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën te dy OE-ve, si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Ekspertet shqyrtues – teknik, sqarojnë se OE ankues "ICN BM", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se OE "ICN BM", ka ofruar çmim disa here me te lart se sa kontrata paraprake dhe poashtu ky çmim është disa here me i lart se sa çmimi i tregut.

Ekspertet shqyrtues – teknik, sqarojnë se lidhur me çmimin e ofruar nga OE ankues, AK-Ministria e Shëndetësisë duke u bazuar ne çmimin e këtij produkti te kontratës paraprake ka bere hulumtim te tregut ku ne shkresat e lendes i ka bashkangjitur edhe disa fatura te këtij produkti ne te cilat rezulton se çmimi i këtij produkti sipas faturave është shume me i ulet se sa çmimi i dhënë ne oferte.
Ekspertet shqyrtues – teknik, sqarojnë se konform nenit 61.4 te LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejt e autoritetit kontraktues, prandaj duke u bazuar vlerësimin e çmimeve AK-ja, e anulon LOT 9 me arsyetimin se çmimet e ofruara nuk janë çmime te tregut. Andaj, duke u bazuar ne sqarimin e mësipërm, pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Sqarimi nr.2

Ekspertet shqyrtues – teknik, sqarojnë se OE ankues "Tri Med", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se OE "Tri Med", nuk e ka plotësuar kriterin: 1. certifikata për prodhuesin ISO 13485:9001 – kopje, 2. Autorizimi nga prodhuesi nuk i përmban te dhëna e kërkuara ne njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit dhe si i tillë është dokument i pa pranueshëm për komisionin e vlerësimit, 3. Mostrat e produkteve, vetëm nga një copë dhe vetëm një dimension për një lloj te produkteve. Ne ofertën e dhënë ka ofruar shiringa te prodhuesit Ahu Hongyu wuzhou medical – Kine, ndërsa mostrën e keni ofruar Beybi nga Turqia. Ne dokumentacionin e ofruar askund nuk figuron Beybi, andaj ka mospërputhje ne dokumentacion.

Ekspertet shqyrtues – teknik, lidhur me arsyetimin e AK-se, ne lidhje me autorizimin e prodhuesit sqarojnë se autorizimi i prodhuesit i dorëzuar ne ofertën origjinale përmban te dhëna përmes te cilave mund ti drejtohet për verifikim ne rast te dyshimit te këtij dokumenti. Ekspertet shqyrtues – teknik sqarojnë se ne autorizim gjenden numrat e telefonit, adresa e prodhuesit. Andaj, ekspertet shqyrtues – teknik vlerësojnë se kjo arsye e eliminimit nga ana e AK-se është e paqëndrueshme.

Lidhur me mostrën e dorëzuar nga OE ankues, për te cilën AK-ja e ka eliminuar për shkak se ka mospërputhje ne dokumentacion, ekspertet shqyrtues –teknik sqarojnë se ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontratë është kërkuar qe te dorëzohet mostra te cilen OE ankues e ka dorëzuar dhe ne mostër figuron qe prodhues i shiringës është: AnHui Hongyu Medical Manufactured Co Ltd. Ndërsa sa i përket emërtimit Beybi te shënuar ne shiringë, ekspertet shqyrtues – teknik sqarojnë se kompania Beybi është importues për Turqi dhe se nuk është prodhues i shiringës. Prandaj, ky arsyetim i AK-se është i paqëndrueshëm.

Ne lidhje me certifikatën e prodhuesit ISO 13485:9001, për te cilën AK-ja e ka eliminuar ekspertet shqyrtues – teknik sqarojnë se, autoriteti kontraktues me datën: 21.02.2017, ka bere verifikim te certifikatës me nr Q2N 14 07 81232 003 (e dorëzuar ne ofertë) tek certifikuesi TUV - Gjermani, ku AK-ja, ka kërkuar sqarim nga certifikuesi ne lidhje me validitetin e kësaj certifikate. Ne po te njëjtën date përfaqësuesi i kompanisë TUV nga Gjermania, i kthen përgjigje AK-MSH-se, përmes se cilës certifikuesi deklaron se certifikata ne fjalë me numër Q2N 14 07 81232 003 <u>është zëvendësuar me certifikatën me nr. Q2N 15 05 81232 005.</u>

Ekspertet shqyrtues – teknik vlerëson se certifikuesi me rastin e deklarimit nuk ka dhënë një përgjigje përfundimtare ne lidhje me certifikatën e lartpërmendur për faktin se certifikuesi është dashur ta sqaroj me shume termin "është Zëvendësuar" sepse nga kjo nuk dihet saktë se a ka pasur validitet certifikata e OE ankues me rastin e dorëzimit te ofertës se tij.
Andaj, me qëllimit te verifikimit te saktë ekspertet shqyrtues – teknik sqarojnë se ky aktivitet i prokurimit duhet te Ri-vlerësohet dhe njëherit i propozojnë panelit shqyrtues qe ta obligoj AK-ne, qe te kërkoj edhe njëherë sqarime me te detajuara nga certifikuesi TUV, ne lidhje me certifikatën e lartpërmendur te OE ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Shëndetësisë**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, me numër të prokurimit: 206/16/103/111, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit për Lot 22, 23 dhe 24 të Rivlerësohet dhe ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa për Lot 9 ekspertet shqyrtues – teknik i propozojnë panelit shqyrtues qe te aprovohet vendimi i AK-se për anulim te këtij aktiviteti te prokurimit ndërsa ankesa e OE ankues "Icn Bm" te refuzohet si e pa bazuar.